

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL NR. 1 TIRANË**

Raporti Përfundimtar “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e aktivitetit janar 2012 deri me 30.09.2013, kryer në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional nr. 1 Tiranë me objekt: *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë; organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile; zbatimi i afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore për likuidimin e detyrimeve fiskale; zbatimin e strukturës organizative, si dhe dispozitave ligjore në fushën e pagave; mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet etj.,”* është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 175 datë 30.12.2013.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 843/6 prot., datë 31.12.2013 dërguar Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional nr. 1 Tiranë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave organizative, për shpërblim dëmi dhe disiplinore.

***Si masa organizative***, midis të tjerave është rekomanduar dhe kërkuar që DRFP nr. 1 Tiranë:

- të marrë masa për krijimin e kushteve për organizimin dhe funksionimin e bordit drejtues, sipas përcaktimeve në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Arsimit nr. 15, datë 23.07.2012 “Për funksionimin e bordeve në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.
- të marrë masa për planifikimin e fondeve të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e bordit drejtues, si dhe të marrë masa për përcaktimin e mënyrës së pjesëmarrjes së bordit në procedurat e emërimit e të largimit të drejtuesit, mësueseve dhe instruktorëve .
- të marrë masa për hartimin e programit ekonomiko-financiar në fillim të çdo viti, sipas përcaktimeve në Statut, në mënyrë që të programohen sa më mirë treguesit dhe të verifikohet arritja e tyre, për një paraqitje sa më të saktë të performancës së Drejtorisë, kryesisht në drejtim të rritjes së të ardhurave.
- të marrë masa për krijimin e komisioneve të marrjes në dorëzim të punimeve civile për kontrata të mundshme, me personel teknik të fushës dhe në mungesë të tyre nga stafi i drejtorisë, të lidhen kontrata me personel jashtë institucionit.
- të hartojë dhe të zbatojë kriteret e veçanta për marrjen në punë të punonjësve të përhershëm dhe të instruktorëve.
- të marrë masa për përcaktimin e sasive të orëve të nevojshme për zhvillimin e kurseve, të planifikuar me kohë të pjesshme; për përshtatjen e kurrikulave dhe orëve duke u mbështetur në standarde të aprovuara.
- të marrë masa për sensibilizimin nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve, si dhe përdorimit të internetit, me synim rritjen e numrit të kursantëve që marrin pjesë në kurset profesionale që organizon kjo drejtori.
- të marrë masa për përmirësimin e Rregullores së institucionit të miratuar me vendim të bordit drejtues nr. 1, datë 13.09.2010, duke pasqyruar përcaktimet në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 15, datë 23.07.2013.
- të marrë masa për përgatitjen, plotësimin e kushteve dhe realizimin e kërkesës për akreditimin e institucionit, sipas kërkesave të nenit 9, të statutit të Drejtorisë.

**Në masat për shpërblim dëmi** është kërkuar për shpërblimin e dëmit prej **25,600 lekë** përfituar padrejtësisht nga subjekti “**██████████**” Sh.p.k, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Bazuar në kontratën individuale të punës dhe Rregulloren e brendshme të institucionit, i **është kërkuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore:** “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës” për z. **██████████** me detyrë Drejtor i DRFP nr. 1 Tiranë, pasi: nuk ka marrë masa për organizimin dhe funksionimin e bordit drejtues; aktiviteti i drejtorisë është zhvilluar pa mbikëqyrjen e bordit drejtues; janë vendosur rregulla të pamjaftueshme për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; nuk është përmirësuar Rregullorja e brendshme; nuk janë përcaktuar kriteret e marrjes në punë të punonjësve të përhershëm dhe të instruktorëve, si dhe të personelit të përhershëm dhe të instruktorëve; nuk është përcaktuar sasia e orëve të nevojshme për zhvillimin e kurseve të planifikuara me kohë të pjesshme; nuk janë respektuar kufijtë ligjor vjetor në prokurimet e blerjeve me vlera të vogla; është ndërruar porosia për disa materiale pas përfundimit të procedurës së prokurimit, duke kaluar në blerje të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” etj.

**Gjithashtu, bazuar në kontratën individuale të punës dhe Rregulloren e brendshme të institucionit i është kërkuar Drejtorisë së Formimit Profesional, fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore:** “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për punonjësin **██████████**, pasi nuk janë respektuar kërkesat ligjore gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik për punime civile.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

*Shënim:* Auditimi u krye nga z. Artan Topjana përgjegjës i grupit, z. Neritan Matoshi dhe z. Agron Maksutaj. Më tej u shqyrtua nga z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**